



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR  
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRËS

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Durrës, më \_\_\_\_\_. \_\_\_\_\_. 2022

# RAPORT MONITORIMI

DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRËS

**PERMBLEDHËSE**

**(JANAR – GUSHT 2022)**

DRAP Durrës është ngritur me Vendimin e Këshillit të Ministrave, Nr. 99, datë 27.02.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të drejtorisë së përgjithshme të arsimit parauniversitar”.

DRAP Durrës, shtrin juridiksionin e tij në të gjitha institucionet arsimore të qarqeve Tiranë, Durrës dhe Dibërnë mbështetje dhe në zbatim të ligjit Nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”(i ndryshuar). Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar (DRAP) Durrës ka në juridiksionin e tij 12 zyra vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP):

- |  |   |
|--|---|
| <input type="checkbox"/> <i>ZVAP Bulqizë</i> | <input type="checkbox"/> <i>ZVAP Krujë</i>      |
| <input type="checkbox"/> <i>ZVAP Dibër</i>   | <input type="checkbox"/> <i>ZVAP Mat</i>        |
| <input type="checkbox"/> <i>ZVAP Durrës</i>  | <input type="checkbox"/> <i>ZVAP Rrogozhinë</i> |
| <input type="checkbox"/> <i>ZVAP Kamëz</i>   | <input type="checkbox"/> <i>ZVAP Shijak</i>     |
| <input type="checkbox"/> <i>ZVAP Kavajë</i>  | <input type="checkbox"/> <i>ZVAP Tiranë</i>     |
| <input type="checkbox"/> <i>ZVAP Klos</i>    | <input type="checkbox"/> <i>ZVAP Vorë</i>       |

Monitorimi i buxhetit të vitit 2022 është procesi i vlerësimit të performancës, i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me treguesit e planifikuar dhe ka për qëllim:

- ❖ Të ofrojë shërbim cilësor në sistemin arsimor parauniversitar nëpërmjet monitorimit, vlerësimit dhe inspektimit.
- ❖ Të organizojë punën për menaxhimin, ndjekjen dhe kontrollin e institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar për pajtueshmërinë e veprimtarisë së tyre me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- ❖ Të koordinojë administrimin e burimeve njerëzore në institucionet arsimore të varësisë, sipas legjislacionit në fuqi.
- ❖ Të sigurojë se funksionet e lidhura me planifikimin, zbatimin, kontabilitetin dhe raportimin financiar për institucionet publike në juridiksionin e saj të kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- ❖ Të vlerësojë nëpërmjet ZAVP-ve, kërkesat e ministrisë përgjegjëse për arsimin si dhe të shqyrtojë për përmbushjen e kritereve infrastrukture për hapjen e institucioneve arsimore dhe ushtrimin e veprimtarisë në fushën e arsimit parauniversitar.
- ❖ Të sigurojë zbatimin e kurrikulës, metodologjitë dhe standardet që mbështesin dhe përmirësojnë procesin e ofrimit të shërbimit arsimor.
- ❖ Të ofrojë ekspertizë teknike në hartimin e metodologjive mësimore, praktikave dhe teknikave që përmirësojnë cilësinë e mësimdhënies.
- ❖ Të menaxhoj dhe mbikëqyr/kontrollon institucionet arsimore parauniversitare lidhur me zhvillimin e veprimtarive mësimore.
- ❖ Të monitorojë kualifikimet e personelit mësimdhënës për kurrikulën, metodologjitë dhe standardet e përcaktuara nga institucioni përgjegjës.
- ❖ Të menaxhojë me përgjegjësi rekrutimin e mësuesve nëpërmjet menaxhimit, mirëmbajtjes, përditësimit të portalit kombëtar “Mësues për Shqipërinë”, ndjekjen e procedurave përkatëse të konkurrimit, përpunimin e analizimin e të dhënave dhe shpalljen e rezultateve.
- ❖ Të organizojnë dhe mbështesin shërbimin psikosocial në institucionet arsimore publike.
- ❖ Të garantoj mirë administrimin e burimeve financiare dhe alokimin e tyre në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nevojat e institucioneve arsimore bazuar në formulën “për nxënës”.
- ❖ Të bashkëpunojë me njësitë e vetëqeverisjes vendore për planifikimin, realizimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së institucioneve arsimore.

- ❖ Të monitorojë procedurat për përzgjedhjen, shpërndarjen dhe pajisjen e nxënësve me tekste shkollore.
- ❖ Të organizoj dhe mbështes zhvillimin e provimeve dhe vlerësimeve kombëtare dhe ndërkombëtare në arsimin parauniversitar.
- ❖ Të inspektojë, monitorojë, vlerësojë, rekomandojë dhe nxjerrin përfundime mbi zbatueshmërinë e kritereve të ligjshmërisë nga institucionet arsimore parauniversitare publike dhe private.
- ❖ Të mbledh dhe përpunoj të dhënat statistikore nga institucionet arsimore në juridiksionin e tyre.
- ❖ Të krijojë një sistemi të përshtatshëm, efektiv dhe eficient të MFK-së konform standardet ligjore, nëpërmjet menaxhimit me bazë performance. Eficenca në përdorim e burimeve financiare e materiale në arsim; efektiviteti në përdorimin e burimeve njerëzore: rritja e kapaciteteve e aftësive menaxhuese në nivelin rajonal (DAR/ ZA), lokal (institucionet arsimore)
- ❖ Të vendos mekanizma transparente të monitorimit të përdorimit të fondeve buxhetore në zbatim të akteve ligjore e nënligjore të sistemit arsimor në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- ❖ Të rrisë dhe zhvillojë kapacitetet planifikuese dhe menaxhuese, nëpërmjet programeve trajnuese

**Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës dhe 12 ZVAP-e në juridiksion të saj** kanë filluar aktivitetin më 20.05.2019, bazuar në VKM nr. 99, datë 27.02.2019 *“Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të drejtorisë së përgjithshme të arsimit parauniversitar”*, të Urdhërit Nr.68 ,datë 5.4.2019 të Kryeministrit *“Për miratimin e strukturës dhe organikës së DPAP dhe DRAP”* dhe të Urdhërit të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr 234, datë 19.04.2019 *“Për miratimin e strukturës dhe të organikës së zyrave vendore të arsimit parauniversitar”*

Buxheti i DRAP Durrës dhe 12.ZVA-et në juridiksion është mbështetur në programin buxhetor afatmesëm 2022-2024 dhe në fondet buxhetore të alokuara për vitin 2022 dhe të rishikuar gjatë vitit 2022,si dhe në prioritetet e përcaktuara në programin e qeverisë, i cili ndahet në tre programe si më poshtë:

- ❖ **01110 - Planifikim menaxhim**
- ❖ **09120 - Arsimi Bazë**
- ❖ **09320 - Arsimi Mesëm i Lartë**
- ❖

Monitorimi i buxhetit për vitin 2022 është realizuar në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 *“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”*, të ndryshuar, të ligjit *“Për buxhetin e vitit 2022”*, të ligjit nr. 10296 *“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”* i ndryshuar, të Udhëzimit nr. 22, datë 17.11.2016 të Ministrit të Financave *“Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore”*, të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 *“Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”*, i ndryshuar , si dhe Udhëzimit Plotësues *“Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”*.



DRAP Durrës dhe 12 ZVA-et në juridiksion të saj është përgjegjëse për funksionimin dhe mbarëvajtjen e institucioneve arsimore brenda juridiksionit të tyre, duke siguruar cilësinë e shërbimit arsimor parauniversitar në nivel rajonal dhe kryen disa detyra të përcaktuara një ndër to është *“Garantimi i miradministrimit të burimeve financiare dhe alokimit e tyre, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nevojat e institucioneve arsimore”*.

Për të përmbushur detyrat janë bërë parashikimet e nevojshme buxhetore, kemi hartuar projekt-buxhetin afatmesëm 2022-2024 sipas nevojave të institucionit dërguar dhe në MASR.

Në vijim po ju paraqesim fondet e akorduara dhe realizimet e shpenzimeve buxhetore në total dhe për cdo program buxhetor, sipas produkteve dhe llogarive ekonomike.


### 1.1 -Realizimi i fondeve buxhetore sipas programeve buxhetore për 8 mujorin 2022 ndaj planit të alokuar për 8 mujorin 2022

		Plani i alokuar për 8 mujorin e parë 2022		Realizimi faktik për 8 mujorin e parë 2022	
		Në (000) Lekë	Në (%) ndaj buxhetit vjetor	Në (000) Lekë	Në (%) ndaj faktit
1110	Planifikim Menaxhim	91.699	1%	82.522	1%
9120	Arsimi Bazë	5.733.738	76%	5.641.563	77%
9230	Arsimi i Mesëm	1.693.023	23%	1.640.651	22%
	<b>TOTALI</b>	<b>7.518.460</b>	<b>100%</b>	<b>7.364.736</b>	<b>100%</b>




### 1.2- Plani buxhetore për vitin 2022 dhe realizimi për 8 mujorin e parë 2022 sipas artikujve

Artikulli		Plani 12-mujor	Fakti 8-mujori 2022
600	Paga personeli	9.165.957	6.090.186
601	Sigurime shoqerore dhe shendetesore	1.565.708	1.063.012
602	Mallra dhe sherbime te tjera	429.173	203.952
606	Transferta per buxhetet familiare dhe individet	9.302	7.587
	<i>Shpenzime korrente</i>	<b>11.170.139</b>	<b>7.364.736</b>
231	Shpenzime kapitale	8.600	
	<i>Shpenzime kapitale</i>	<b>8.600</b>	<b>0</b>
	<b>TOTALI</b>	<b>11.178.739</b>	<b>7.364.736</b>



### 1.3- Plani buxhetore për vitin 2022 ne % për 8 mujorin e parë sipas artikujve

Artikulli	Përshkrimi	Plani 12-mujor	
		Në (000) Lekë	Në (%) ndaj buxhetit vjetor
600	Paga personeli	9.165.957	82%
601	Sigurime shoqerore dhe shendetesore	1.565.708	14%
602	Mallra dhe sherbime te tjera	429.173	4%
606	Transferta per buxhetet familiare dhe individet	9.302	0%
231	Aktive afatgjata materiale	8.600	0
	<b>TOTALI</b>	<b>11.178.739</b>	<b>100%</b>



#### 1.4 -Fondet e përdorura për vitin 2022 sipas arikujve në të gjithë programet për DRAP Durrës dhe 12 ZVAP-et në juridiksion.



000/lekë

Artikulli	Përshkrimi	Plani 12-mujor		Fakti 4-mujori parë 2022	
		Në (000) Lekë	Në (%) ndaj buxhetit vjetor	Në (000) Lekë	Në (%) ndaj planit 12-mujor
600	Paga personeli	9.165.957	82%	6.090.186	83%
601	Sigurime shoqerore dhe shendetesore	1.565.708	14%	1.063.012	14%
602	Mallra dhe sherbime te tjera	429.173	4%	203.952	3%
606	Transferta per buxhetet familiare dhe individet	9.302	0%	7.587	0%
	<b>Shpenzime korrente</b>	<b>11.170.139</b>	<b>100%</b>	<b>7.364.736</b>	<b>100%</b>
230	Aktive afatgjata jomateriale				
231	Aktive afatgjata materiale	8.600			
	<b>Shpenzime kapitale</b>	<b>8.600</b>	<b>0%</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
	<b>TOTALI</b>	<b>11.178.739</b>	<b>100%</b>	<b>7.364.736</b>	<b>100%</b>



#### 1.5 Plani dhe Faktiku ne % që zë cdo ZVAP ndaj planit total per DRAP +12 ZVAP –et në juridiksion

DRAP Durrës	Plani I alokuar DRAP+12 ZVAP-e për vitin 2022 vjetor	Faktiku I realizimit DRAP+12 ZVAP-e për periudhën 8 mujorit 2022
DRAP Durrës	51.097	9.823
ZVAP Krujë	664.663	440.095
ZVAP Bulqizë	399.566	236.577
ZVAP Tiranë	4.774.224	3.211.077
ZVAP Rrogozhinë	275.519	172.086
ZVAP Kavajë	444.807	287.242
ZVAP Durrës	1.635.512	1.081.429
ZVAP Mat	370.232	226.416
ZVAP Vorë	326.339	211.630
ZVAP Kamëz	931.112	639.751
ZVAP Shijak	235.987	150.391
ZVAP Dibër	808.276	535.575
ZVAP Klos	261.406	162.645
<b>TOTALI</b>	<b>11.178.739</b>	<b>7.364.736</b>



- **Planifikim Menaxhim** – Fondet e rishikuara buxhetore janë **137.517** (Njëqindë e tridhjetë e shtatë mijë e pesëqindëeshtatëmbëdhjetë) 000/lekë, ose **1 %** të buxhetit total.
- **Arsimi Bazë** – Fondet e rishikuara buxhetore janë **8.518.851** (Tetë milion e pesëqindëetëmbëdhjetë e tetëqindëepesëdhjetëe një) 000/lekë, ose **76 %** të buxhetit total.
- **Arsimi i Mesëm** ( i përgjithshëm), fondet e rishikuara buxhetore 2.522.372 (Dymilion e pesëqindë e njëzetë e dymijë e treqindë e shtatëdhjetë e dy.) 000/lekë ose **23 %** të buxhetit total.

Për periudhën Janar-Gusht 2022 janë planifikuar për tu shpenzuar **7.518.460** (Shtatëmilione pesëqindëetëmbëdhjetë mijë e katërqindë e gjashtëdhjetë) 000/lekë. Janë përdorur për periudhën 8 mujori 2022 fondi prej **7.364.736 në 000/lekë ose 97.95 %** e buxhetit total për 8 mujorin e vitit 2022.


Driferenca e mosrealizimit të periudhës me **2.05 %** apo **153.724** në 000/ lekë vjen për arsyet e mëposhtëme:

- DRAP Durrës dhe 12 ZVA-et në juridiksion të saj ka parashikuar fondet për **150** punonjës (137+13 sanitare) sipas strukturës organike të miratuar për punonjës në Administratë me ndryshimet gjatë vitit 2022 realisht për 8 mujorin 2022 janë paguar gjithsej 148 punonjës. Pra kemi vakanca prej 2 punonjësish.
- Në Arsimi Bazë për viti 2022 kemi të miratuar gjithsej **8.769** punonjës mësimor. Me ndryshimet gjatë vitit 2022 faktikisht janë paguar mesatarisht 8.707 punonjës mësimor. Relatojmë se vetë procedura e emërimeve në zbatim të portalit “Mësues për Shqipërinë” kërkon pak kohë të realizohet punësimi sidomos për ZVAP –et që në fituesit e portalit të tyre nuk kanë profile qe ju duhen dhe duhet të njoftojnë nga ZVAP-et e tjera. Për ZVAP Mat, Klos, Krujë, Kavajë, Shijak, Bulqizë dhe Rrogozhinë kanë numër punonjës mësimor të papërdorur referuar kjo numrit të nxenesve të rregjistruar, apo dhe koha që duhet për plotësimin sipas kërkesave për Vende vakante apo provizore të shërbimit psiko-social apo të Oficerëve të Sigurisë.
- Në **Arsimin e Mesëm të Lartë** për vitin 2022 kemi të miratuar gjithsej **2.499** punonjës mësimor . Faktikisht janë paguar mesatarisht **2.487** punonjës mësimor. Relatojmë se vetë procedura e emërimeve në zbatim të portalit “Mësues për Shqipërinë” kërkon pak kohë të realizohet punësimi sidomos për ZVAP –et që në fituesit e portalit të tyre nuk kanë profile qe ju duhen dhe duhet të njoftojnë nga ZVAP-et e tjera si dhe për ZVAP Mat dhe Klos kanë numër punonjës mësimor më shumë se ju duhen referuar numrit të nxenesve të rregjistruar.
- Pra ne total planifikuar **11.404+13 sanitar gjithsej 11.418** punonjës, dhe faktikisht janë paguar 11.342 punonjës pra më pak 76 punonjës pra numri i punonjësve faktikë mesatar për periudhë buxhetore ka qenë i paplotësuar përgjatë periudhës së 8 mujorit të vitit 2022 .
- Sqarojmë se e numrit te organikave për shërbimin psiko-social është plotësuar gjatë vitit 2022 dhe vazhdon të jetë akoma me sistemime.
- Në lekë fondi i papërdorur për artikullin 600+601 në total për 3 programet është 7.153198 në 000/ lekë ose 99.15 % të fondit të planifikuar për periudhën e 8 të vitit 2022.
- Për arsye të vetë volumit të punës për realizimin nga ana e DRAP Durres të prokurimeve për 12 ZVAP-et në juridiksion si dhe të vetë ZVAP-eve ,lidhur me afatet për prokurim bazuar në Legjislacionin në fuqi , fondet e papërdorur në artikullin 602 total për 3 programet është 203.952 në 000/lekë ose 71.28 % te fondit të planifikuar
- Në artikullin 606 Transferta per buxhetin familjar & individ janë përdorur 7.587 në 000/lekë përdorur ose 81.56 % të cilat janë alokuar për këtë periudhë.

- Në artikullin 231 Kapitale të Trupëzuara për vitin 2021 u alokua një fond prej 6.450.000 lekë për krijimin e fondit të bibliotekave në Arsimin Bazë dhe fondi prej 2.150.000 lekë në Arsimin e mesëm të Lartë . DRAP Durrës është në procesin e prokurimit bazuar në mbledhja e kërkesave nga ZVAP-et sipas kërkesave për frymë.




### 1.6 –Parashikimi I fondeve në PBA 2022 dhe alokimi i tyre për vitin 2022

Artikulli	Përshkrimi	PBA 2022	Plani 12-mujor 2022
			Në (000) Lekë
600	Paga personeli	10.201.502	9,165,957
601	Sigurime shoqerore dhe shendetesore	1.637.206	1,565,708
602	Mallra dhe sherbime te tjera	415.136	429,173
606	Transferta per buxhetet familiare dhe individet	460.758	9,302
	<b>Shpenzime korrente</b>	<b>12.714.602</b>	<b>11,170,139</b>
230	Aktive afatgjata jomateriale	0	
231	Aktive afatgjata materiale	136.729	8,600
	<b>Shpenzime kapitale</b>	<b>136728,95</b>	<b>8600</b>
	<b>TOTALI</b>	<b>12.851.331</b>	<b>11,178,739</b>



### 1.7 –Parashikimi I fondeve në PBA ,alokimi i tyre për vitin dhe faktiku per vitin 2022

		PBA 2022 000/lekë	Plani vjetor 2022 në 000/lekë	Në (%) ndaj planit 12- mujor	Faktiku I realizuar për 4 mujorin e parë 2022 në 000/lekë	Në (%) ndaj planit për vitin 2022
600	Paga personeli	10.201.502	9.165.957	82%	6.090.186	83%
601	Sigurime shoqerore dhe shendetesore	1.637.206	1.565.708	14%	1.063.012	14%
602	Mallra dhe sherbime te tjera	415.136	429.173	4%	203.952	3%
606	Transferta per buxhetet familiare dhe individet	460.758	9.302	0%	7.587	0%
231	Aktive afatgjata materiale	136.729	8.600	0	0	0
	<b>TOTALI</b>	<b>12.851.331</b>	<b>11.178.740</b>	<b>100%</b>	<b>7.364.736</b>	<b>100%</b>



## 1.8- Relacion mbi fëmijët me aftësi të kufizuar

DRAP Durrës për 12 ZVAP-et në juridiksion ka gjithsej 1.780 fëmi me AK

## 1.9-Relacion për mësuesit ndihmës

Mësues ndihmës në DRAP Durrës për 12 ZVAP-et në juridiksion janë gjithsej 710 mësues

**1.10** – Në DRAP Durrës gjatë vitit 2022 ka punuar për organizimin e shërbimit psikosocial. Gjatë vitit 2022 është punuar për plotësimin me punonjës **Psiko-Social** bazuar në kërkesat e ZVAP-eve për në mbështetje të Urdhrit të Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë me nr. 313, datë 20.10.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e njësisë së shërbimit psiko-social në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psikosocial”, për 12 ZVAP-et në juridiksion të DRAP Durrës janë **286** gjithsej.

## 2.0- Për Oficerët e Sigurisë

**Nisma ”Shkolla të sigurt – Oficerët e Sigurisë në shkolla”** është një iniciativë e ndërmarrë nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve (MASR) dhe Ministria e Brendshme, e cila i jep një vëmendje të posaçme rritjes së sigurisë, si brenda ashtu dhe përreth institucioneve arsimore. Qëllimi i kësaj nisme të përbashkët është garantimi i një mjedisi të nxëni të sigurt për nxënësit, stafin dhe komunitetin e shkollës. DRAP Durrës për 12 ZVAP-et në juridiksion ka gjithsej 61 Oficerë Sigurie

## 2.1 - Programi buxhetor PLANIFIKIM-MENAXHIM. (Titulli i programit 01110);

---




Krijimin e një sistemi të përshtatshëm, efektiv dhe eficient të MFK-së konform standardet ligjore, nëpërmjet menaxhimit me bazë performance. Eficenca në përdorim e burimeve financiare e materiale në arsim; efektiviteti në përdorimin e burimeve njerëzore: rritja e kapaciteteve e aftësive menaxhuese në nivelin rajonal (DAR/ ZA), lokal (institucionet arsimore); Vendosja e mekanizmave transparente të monitorimit e llogaridhënie. Zbatimin e akteve ligjore e nënligjore të sistemit arsimor në përputhje me legjislacionin në fuqi  
Objektivat e përcaktuara për programin “**PLANIFIKIM-MENAXHIM**” janë:

- **Objektivi 1.** Kryerja e pagesave të pagave dhe sigurimeve brenda afateve ligjore dhe në zbatim të plotë të ligjit.
- **Objektivi 2.** Përdorimi i drejtë i fondeve për shpenzime operative bazuar në legjislacionin në fuqi.
- **Objektivi 3.** Dhënia e shpërblimeve dhe ndihmës financiare nga fondi i veçantë për punonjës që dalin në pension dhe raste fatkeqësish, si dhe pagesat e dietave të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës si dhe cdo lloj pagese tjetër të bazuar në ligj
- **Objektivi 3.** Zbatimi e një sistemi të përshtatshëm, efektiv dhe eficient të MFK-së konform standardet ligjore dhe nënligjore, për implement të planeve strategjike të arsimit me synim përdorimin me eficensë dhe efektivitetin në punë të burimeve njerëzore, nëpërmjet përmirësimit të kushteve të punës, mundësisht dhe rinovimit të paisjeve e aseteve të qëndrueshme, pajisjeve të zyrave, pajisje teknologjike, rikonstruksionin/zgjerimit e objekteve ekzistuese.
- **Objektivi 4.** Inspektimin e monitorimin e cilësisë së shërbimit arsimor mbi bazën e treguesve, duke ndërtuar një sistem të qëndrueshëm e transparent inspektimi dhe monitorimi, në planifikimin dhe përdorim e burimeve njerëzore, financiare dhe materiale në arsim.



**2.2- Realizimi i fondeve buxhetore për programin “Planifikim Menaxhim Administrim” sipas llogarive ekonomike dhe arritja e objektivave për periudhën e 8 mujorit 2022.**

		PBA 2022 000/lekë	Plani vjetor 2022 në 000/lekë	Në (%) ndaj planit 12- mujor	Faktiku I realizuar për 4 mujorin e parë 2022 në 000/lekë	Në (%) ndaj planit për vitin 2022
600	Paga personeli	117,551	105,680	72%	63,683	77%
601	Sigurime shoqerore dhe shendetesore	18,696	17,649	12%	10,790	13%
602	Mallra dhe sherbime te tjera	38,811	14,123	10%	8,034	10%
606	Transferta per buxhetet familiare dhe individet	1,020	65	0%	15	0%
231	Aktive afatgjata materiale	14,899	8.600	6%	0	
<b>TOTALI</b>		<b>190,978</b>	<b>137,517</b>	<b>100%</b>	<b>82,522</b>	<b>100%</b>



- **Artikulli 600+601** – DRAP Durrës dhe 12 ZVA-et në juridiksion të saj, shumën e shpenzuar për “*Paga dhe sigurime personeli*” është **74.473 në 000/lekë** nga **82.219 në 000/lekë** që ishin planifikuar, shpenzimet janë realizuar si 8 mujori i parë në masën **90.58 %** ndaj planit 8 mujor ne total total , për shkak se parashikimi i buxhetit është bërë për 150 punonjës sipas organikës, ndërsa në fakt kanë ushtruar aktivitetin e tyre me punonjës më pak, pra gjatë vitit 2022 ka patur vakanca dhe lëvizje punonjësish.

Deklarimet në sistemin e tatimeve E-TAX për punësimet/largimet e punonjësve, si dhe deklaratimet e sigurimeve janë kryer brenda afateve ligjore. Pagat dhe sigurimet e punonjësve janë likuiduar deri më datë 5 të cdo muaji.

- **Artikulli 602** - Shuma e shpenzuar për “*Mallra dhe sherbime te tjera*” është **8.034 në 000/lekë** nga **9.415 në 000/lekë** që ishin parashikuar, ose **85.32 %** e fondit të planifikuar ne artikullin 602 për 8 mujorin 2022. Kjo llogari përbëhet nga shpenzimet operative për krijimin e kushteve të administrates për të ushtruar detyrat, si furnizimi me energji elektrike, ujë të pijshem, kancelari, etj.
- **Artikulli 606** – Për 8 mujorin e parë 2022 janë shpenzuar “*Transferta per buxhetet familiare dhe individet*” 15 në 000/lekë nga 65 në 000/lekë të alokuara si 8 mujor ose 23.07% e planit për raste që kanë të drejtën e këtij përfitimi.

## **II - ARSIMI BAZË. (Titulli buxhetor i programit 09120)**




Sigurimi i një arsimit cilësor dhe për të gjithë nxënësit duke përmirësuar kushtet e mësimdhënies e mësimnxënies duke siguruar kushte të barabarta për pjesëmarrje në arsimin bazë, për të gjithë fëmijët e grup moshës në arsimin parashkollor dhe atë të detyruar. Arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës me synim plotësimin e standardeve Europiane. Rritja e aksesit në AP, përfshirja e 100% e fëmijëve 5 vjeçare në klasat përgatitore; Rritja e viteve të shkollimit. Rritja e autonomisë së shkollave; Ulja e nxënësve që braktisin shkollën në AB, Tërheqja e fëmijëve romë/egjiptian në AB. Rehabilitimi/ndërtimi i kopshteve /shkollave sipas standardeve. Rritja e cilësisë së mësimdhënies, trajnimi i mësuesve, pajisja e shkollave me laborator shkencorë e IT, krijimi i bibliotekave dixhitale për kurrikulën e AB, Shtrirja e shërbimit të punonjesit social dhe psikologut sipas standardeve të krahasuara me ato të vendeve të zhvilluara. Subvecioni i teksteve shkollore .

Objektivat e përcaktuara për programin “Arsimi Bazë” janë:

- **Objektivi 1.** Kryerja e pagesave të pagave dhe sigurimeve brenda afateve ligjore dhe në zbatim të plotë të ligjit.
- **Objektivi 2.** Realizimi në kohë dhe me efektivitet i transfertave të fondit të veçantë për shpërblimet për punonjës që dalin në pension, ndihmës financiare për raste fatkeqësish
- **Objektivi 3.** Shpenzimi i drejtë dhe me ekonomi i fondeve për shpenzime operative për vazhdimësinë e procesit mësimor.
- **Objektivi 4.** Ofrimi në kohë dhe mbulimi i shpenzimeve të shërbimit të transportit për mësuesit dhe nxënësit e Arsimit Bazë që përfitojnë në bazë të ligjit.
- **Objektivi 5.** Sigurimi i vazhdimësinë së procesit mësimor dhe rritja e cilësisë.
- **Objektivi 6.** Rehabilitimi/ndërtimi i shkollave sipas standardeve
- **Objektivi 7.** Rritja e cilësisë së mësimdhënies, trajnimi i mësuesve, pajisja e shkollave me laborator shkencorë e IT, krijimi i bibliotekave dixhitale për kurrikulën e AB.
- **Objektivi 8.** Shtrirja e shërbimit të punonjesit social dhe psikologut sipas standardeve të krahasuara me ato të vendeve të zhvilluara.
- **Objektivi 9.** Sigurimi i librave falas për kategori të vecantë duke synuar për arsimin bazë librat falas për të gjithë nxënësit

**2.3-Realizimi i fondeve buxhetore për programin “Arsimi Bazë” sipas llogarive ekonomike dhe arritja e objektivave për vitin 2022.**

		PBA 2022 000/lekë	Plani vjetor 2022 në 000/lekë	Në (%) ndaj planit 12-mujor	Faktiku I realizuar për 8 mujorin 2022 në 000/lekë	Në (%) ndaj planit për vitin 2022
600	Paga personeli	7,716,886	6,939,325	81%	4,650,549	82%
601	Sigurime shoqerore dhe shendetesore	1,227,387	1,191,831	14%	806,320	14%
602	Mallra dhe sherbime te tjera	312,174	374,184	4%	179,042	3%
606	Transferta per buxhetet familiare dhe individet	416,104	7,061	0%	5,652	0%
231	Aktive afatgjata materiale	95,810	6,450	0	0	0
<b>TOTALI</b>		<b>9,768,362</b>	<b>8,518,851</b>	<b>100%</b>	<b>5,641,563</b>	<b>100%</b>



- **Artikulli 600+601** – Shuma e shpenzuar për **“Paga dhe sigurime personeli”** është **5.470.770 në 000/lekë** nga **5.456.870 në 000/lekë** të planifikuara për periudhën 8 mujore 2022, shpenzimet për këto zëra janë realizuar në masën 99.74 % ndaj planit vjetor 2022 ,këtu ndikim ka mosplotësimin të organikave në kohë në zbatim të Udhëzimit nr.12, datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar”  
Deklarimet në sistemin e tatimeve E-TAX për punësimet/largimet e punonjësve, si dhe deklarimet e sigurimeve janë kryer brenda afateve ligjore. Pagat dhe sigurimet e punonjësve janë likuiduar deri më datë 5 të cdo muaji,kjo pasi ka ZVAP-e me numër të lartë punonjësish mësimesor.
- **Artikulli 602** - Shuma e shpenzuar për **“Mallra dhe sherbime te tjera”** është **179.042 në 000/ lekë** nga **249.456 ose 98.98 % ndaj planit 8 mujor 2022** lekë të planifikuara, janë alokuar për ZVAP-et fonde vetëm për mbulimin e shpenzimeve të transportit për mësuesit që udhëtojnë mbi 5 km dhe nxënësve mbi 2 km nga qendra e banimit.
- **Artikulli 606** - Shuma e shpenzuar për **“Transferta per buxhetet familiare dhe individet”** është **5.652 në 000/lekë nga 7 061 në 000/lekë** fond i vecantë për dalje në pension ,semundje të rëndë apo raste fatkeqësie gjatë periudhës Janar-Gusht 2022, pas shqyrtimit të dokumentacionit të ardhur nga ZVAP-et janë dërguar kërkesat për miratim në MASR janë shpenzuar për këta përfitues
- **Artikulli 231** –Investime Krijim fond bibliotekash për shkollat e arsimit bazë për vitin 2022 është përdorur një fond prej 6.450 në 000/lekë nga të cilat kanë rezultuar fitues 7 operatorë fitues dhe po vijont puna per prokurimin e fondit te mbetur.

### III - ARSIMI I MESËM I PËRGJITHSHËM. (Titulli i programit 09230);

Programi synon krijimin e shanseve të barabarta për të gjithë nxënësit për një arsim cilësor, e bashkëkohor; mirë menaxhim të burimeve njerëzore; fuqizimin dhe rritjen e autonomisë shkollore; shtrirjen dhe zgjerimin e arsimit të mesëm të përgjithshëm; për rritjen e nivelit të arsimit të popullsisë, për ta përafuar atë me standardet evropiane dhe për të përgatitur qytetarë më të aftë për një shoqëri demokratike. Arsimi i mesëm i lartë synon zhvillimin e mëtejshëm të kompetencave të fituara nga arsimi bazë, konsolidimin e individualitetit të çdo nxënësi dhe tërësinë e vlerave e të qëndrimeve, zgjerimin dhe thellimin në fusha të caktuara të dijes, përgatitjen për arsimin tretësor ose për tregun e punës. Hartimi dhe zbatimi i kurrikules së re në arsimin e mesëm. e zhvillimit profesional të mësuesve. Promovimi dhe zgjerimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në edukim. Zgjerimi i kapaciteteve infrastrukturore në institucionet shkollore të arsimit të mesëm.




**Qëllimi i politikës;** “Krijimi i mundësive për çdo nxënës që përfundon arsimin bazë të regjistrohet në arsimin e mesëm të lartë në masën në masën 98-99% në fund të vitit 2022, përfshirë dhe arsimin profesional. Zbatimi i kurrikulës së re (me kompetenca). Rritja e cilësisë së mësimdhënies, nëpërmjet trajnimit të përvitshëm të mësuesve, drejtuesve Institucioneve Arsimore(IA) dhe drejtuesve të rrjeteve profesionale si dhe zhvillimit profesional të tyre, sipas sistemit të ri për zhvillimin e vazhdueshëm profesional. Realizimi çdo vit i Maturës Shtetërore dhe portalit "Mësues për Shqipërinë". Përmirësimi i standardeve infrastrukturore” .

#### **Objektivat kryesore:**

- **Objektiv 1.** Nxënës që regjistrohet dhe ndjekin arsimin e mesëm të lartë të arrijë në 95-97% e nxënësve që përfundojnë arsimin bazë.
- **Objektiv 2.** Zbatimi i kurrikules së re dhe trajnimi i mësuesve në gjimnaze dhe shkollat social-kulturore, si dhe zbatimi i sistemit të ri të zhvillimit profesional.
- **Objektiv 3.** Përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese në arsimin e mesëm shkollat
- **Objektivi 4.** Shpenzimi i drejtë dhe me ekonomi i fondeve për shpenzime operative për vazhdimësinë e procesit mësimor.
- **Objektivi 5.** Ofrimi në kohë dhe mbulimi i shpenzimeve të shërbimit të transportit për mësuesit e Arsimit të Mesëm që përfitojnë në bazë të ligjit.
- **Objektivi 6.** Sigurimi i vazhdimësinë së procesit mësimor dhe rritja e cilësisë.
- **Objektivi 7.** Realizimi në kohë dhe me efektivitet i transfertave të fondit të veçantë për shpërblimet për punonjës që dalin në pension, ndihmës financiare për raste fatkeqësish
- **Objektivi 8.** Kryerja e pagesave të pagave dhe sigurimeve brenda afateve ligjore dhe në zbatim të plotë të ligjit.

**2.4-Realizimi i fondeve buxhetore për programin “Arsimi Mesëm i Lartë ” sipas llogarive ekonomike dhe arritja e objektivave për vitin 2022.**

		PBA 2022 000/lekë	Plani vjetor 2022 në 000/lekë	Në (%) ndaj planit 12-mujor	Faktiku I realizuar për 8 mujorin 2022 në 000/lekë	Në (%) ndaj planit për vitin 2022
600	Paga personeli	2,367,065	2,120,952	84%	1,375,954	84%
601	Sigurime shoqerore dhe shendetesore	391,122	356,228	14%	245,901	15%
602	Mallra dhe sherbime te tjera	64,151	40,866	2%	16,876	1%
606	Transferta per buxhetet familiare dhe individet	43,634	2,176	0%	1,920	0%
231	Aktive afatgjata materiale	26,020	2,150	0	0	0
<b>TOTALI</b>		<b>2,891,992</b>	<b>2,522,372</b>	<b>100%</b>	<b>1,640,651</b>	<b>100%</b>



- **Artikulli 600+601** – Shuma e shpenzuar për **“Paga dhe sigurime personeli”** është 1.621.854 në 000/lekë lekë nga 1.661.453 në 000/ lekë që ishin planifikuar për vitin 2022, shpenzimet për këto zëra janë realizuar në masën 97.62 % nga plani 8 mujor 2022. Këtu ka ndikim mosplotësimi i organikës me punonjës mësimor gjatë gjithë kohës..  
Deklarimet në sistemin e tatimeve E-TAX për punësimet/largimet e punonjësve, si dhe deklarimet e sigurimeve janë kryer brenda afateve ligjore. Pagat dhe sigurimet e punonjësve janë likuiduar deri më datë 5 të cdo muaji, kjo pasi ka ZVAP-e me numër të lartë punonjësish mësimor.
- **Artikulli 602** Shuma e shpenzuar për **“Mallra dhe sherbime te tjera”** është **16.876 në 000/ lekë** nga **27.244 në 000/ lekë** të planifikuara për periudhën Janar-Gusht 2022 ose 61.94 %.  
Shpenzime për transportin e nxënësve që kanë vendbanimi mbi 2 km nga shkolla dhe mësuesve që punojnë mbi 5 Km nga vendbanimi/qendra e përhershme e punës bazuar nëVKM NR. 398, DATË 3.5.2017 Për disa ndryshime në vendimin nr.682, datë 29.7.2015, të këshillit të ministrave, “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, të ndryshuar  
1. Përballimin nga fondet publike të shpenzimeve për transportin e:  
a) Punonjësve mësimorë të arsimit parauniversitar, ku përfshihen punonjësit e arsimit parashkollor, arsimit fillor, arsimit të mesëm të ulët dhe të arsimit të mesëm të lartë (drejtor, nëndrejtor, mësues, edukator), të institucioneve arsimore publike, që punojnë jashtë qendrave urbane, qytetit/fshatit, larg vendbanimit të përhershëm të tyre, në largësinë mbi 5 km dhe kthehen brenda ditës në vendbanim;”.  
b) nxënësve që ndjekin institucionet arsimore publike të arsimit bazë ose kopshtet publike, që udhëtojnë, nga vendbanimi i përhershëm në një vendbanim tjetër, mbi 2 km larg institucioneve arsimore publike më të afërta (shkollë/kopsht); Në asnjë rast nuk përfitojnë shpenzime transporti nxënësit/fëmijët që udhëtojnë mbi 2 km, nëse në vendbanimin e tyre funksionojnë institucionet arsimore publike (shkollë/kopsht).


c) nxënësve që jetojnë në qendra rezidenciale të krijuara me vendim të Këshillit të Ministrave për grupe të nxënësve/fëmijëve/familjeve që vijnë nga shtresa sociale në nevojë dhe që udhëtojnë mbi 2 km larg për të ndjekur mësimin në institucionet arsimore publike më të afërta (shkollat e arsimit bazë ose kopshtet publike);

ç) nxënësve të arsimit parauniversitar me aftësi të kufizuara që gëzojnë statusin ligjor të invalidit, që nuk shikojnë, që nuk dëgjojnë, invalidit paraplegjik dhe invalidit tetraplegjik

- **Artikulli 606** - Shuma e shpenzuar për “*Transferta per buxhetet familiare dhe individet*” për fond të vecantë për dalje në pension ,semundje të rëndë apo raste fatkeqësie gjatë periudhës Janar-Gusht 2022, pas shqyrtimit të dokumentacionit të ardhur nga ZVAP-et kërkesat për miratim dërguar në MASR, janë shpenzuar 1.920 në 000/lekë nga 2.179 në 000/lekë
- **Artikulli 231** –Investime Krijim fond bibliotekash për shkollat e arsimit e mesëm në vlerën 2.150 në 000/lekë nga të cilat kanë rezultuar fitues 7 operatore fitues po vijohet puna per prokurimin e fondit te mbetur.


**2.5-Numri I nxënësve dhe mësuesve që kanë përfituar shpenzime transporti për 8 mujorin 2022 në Arsimin Bazë dhe Arsimin e Mesëm të Lartë.**

DRAP Durrës	Numri i nxenesve dhe mesuesve qe kane perfituar shpenzime transporti ne Arsimin Baze dhe të mesëm të lartë
ZVAP Rrogozhine	478
ZVAP Vore	815
ZVAP Mat	895
ZVAP Klos	1.093
ZVAPBulqize	975
ZVAP Kavaje	778
ZVAP Kamez	323
ZVAP Kruje	1.808
ZVAP Durres	3.355
ZVAP Shijak	658
ZVAP Tirane	2.200
ZVAP Diber	1.951
<b>TOTALI</b>	<b>15.329</b>




**2.6-Fondi i përdorur në Arsimin Bazë dhe të Mesëm të Lartë për 8 mujorin 2022 nga 12 ZVAP-et në juridiksion të DRAP Durrës për shpenzime transporti.**

DRAP Durrës	Fondi I përdorur raportuar ne situacionin e 8 mujorit 2022 për shërbimin e transportit
ZVAP Kamëz	6.546.257
ZVAP Vorë	8.713.180
ZVAP Bulqizë	13.827.670
ZVAP Tiranë	16.449.720
ZVAP Klos	8.873.208
ZVAP Durrës	8.992.440
ZVAP Dibër	4.847.640
ZVAP Rrogozhinë	26.532.304
ZVAP Kavajë	30.056.600
ZVAP Shijak	5.849.670
ZVAP Mat	28.631.708
ZVAP Krujë	12.033.668
<b>TOTALI</b>	<b>171.354.065</b>




## 2.7- Numri I punonjësve të Planifikim Menaxhimit bashkë me numrin e miratuar të punonjësve me kontratë (sanitare)

Numri I punonjësve të Planifikim Menaxhimi për DRAP +12 ZVAP			
	Plani Nr I punonjësve I miratuar viti 2022	Fakti mesatar I punonjësve të paguar në 4 mujorin 2022	Sanitare
DRAP DURRES	15	14	1
ZVAP Kamez	11	11	1
ZVAP Mat	6	6	1
ZVAP Kruje	8	6	1
ZVAP Kavaje	8	8	1
ZVAP Klos	6	6	1
ZVAP Shijak	6	6	1
ZVAP Vore	6	6	1
ZVAP Rrogozhine	6	5	1
ZVAP Diber	9	8	1
ZVAP Tirane	35	35	1
ZVAP Bulqize	6	4	1
ZVAP Durres	15	15	1
<b>TOTALI</b>	<b>137</b>	<b>133</b>	<b>13</b>




## 2.8- Numri I punonjësve të Arsimit Bazë për 12 ZVAP-e në juridiksion të DRAP Durrës

Numri I punonjësve të Arsimit Bazë për 12 ZVAP-e në juridiksion të DRAP Durrës per vitin 2022		
	Plani Nr I punonjësve I miratuar viti 2022	Fakti mesatar i paguar I punonjësve per 8 mujorin 2022
ZVAP Mat	276	276
ZVAP Durres	1.267	1267
ZVAP Klos	189	189
ZVAP Rrogozhine	240	229
ZVAP Diber	676	676
ZVAP Kruje	534	534
ZVAP Kavaje	367	350
ZVAP Vore	251	245
ZVAP Shijak	198	198
ZVAP Bulqize	326	298
ZVAP Kamez	787	787
ZVAP Tirane	3.658	3.658
<b>TOTALI</b>	<b>8.769</b>	<b>8.707</b>



## 2.9- Numri I punonjësve të Arsimit Mesëm të Lartë për 12 ZVAP-e në juridiksion të DRAP Durrës


Numri I punonjësve të Arsimit të Mesëm të Lartë për 12 ZVAP-e në juridiksion të DRAP Durrës per vitin 2022		
	Plani Nr I punonjësve I miratuar viti 2022	Fakti mesatar i paguar I punonjësve per 8 mujorin 2022
ZVAP Mat	81	81
ZVAP Kamez	208	208
ZVAP Kruje	116	116
ZVAP Kavaje	75	75
ZVAP Klos	48	48
ZVAP Shijak	34	34
ZVAP Vore	64	60
ZVAP Rrogozhine	35	35
ZVAP Diber	135	135
ZVAP Tirane	1.302	1.302
ZVAP Bulqize	69	60
ZVAP Durres	332	332
<b>TOTALI</b>	<b>2.499</b>	<b>2.486</b>



### 3-0. KRAHASIMI I FONDEVE TE ALOKUARA 2020-2021-2022

Artikulli	Përshkrimi	Plani 2020	Plani 2021	Plani 2022
600	Paga personeli	8.068.148	8.976.569	9.165.957
601	Sigurime shoqerore dhe shendetesore	1.262.806	1.470.978	1.565.708
602	Mallra dhe sherbime te tjera	232.996	280.504	429.173
606	Transferta per buxhetet familiare dhe individet	381.944	497.242	9.302
231	Aktive afatgjata materiale	0	5.045	8.600
	<b>TOTALI</b>	<b>9.945.894</b>	<b>11.230.338</b>	<b>11.178.739</b>

#### Planet e alokuara për vitet 2020-2021-2022




#### 3.-1. Informacion për IPAP për 12 ZVAP-et

NR	ZVA	KOPSHTE GJITHSEJ		TOTALI KOPSHTE	Shkolla Publike (drejtori me vete)		TOTALI SHKOLLA PUBLIKE	Shkolla Private		TOTALI SHKOLLA PRIVATE
		PUBLIKE	PRIVATE		9-vjecare +Mesme te Bashkuara	Gjimnaze + mesme të orientuara te Veçanta		9-vjecare	Mesme	
1	ZVA MAT	30	0	30	10	2	12	0	0	0
2	ZVA KLOS	23	0	23	10	1	11	0	0	0
3	ZVA VORE	12	0	12	11	2	13	0	0	0
4	ZVA RROGOZHINE	17	0	17	10	1	11	0	0	0
5	ZVA KAMEZ	20	7	27	23		23		1	1
6	ZVA KAVAJE	29	1	30	16	2	18	0	0	0
7	ZVA DIBER				35	3	38	0	0	0
8	ZVA KRUIJE	27	1	28	24	2	26	0	0	0
9	ZVA TIRANE	43	140	189	97 +13 MB +3AF+3AMU	19AML+4MB +IPART TIME	140	16	13+29 MB	58
10	ZVA SHIJAK	17	3	20	12	2	14	0	0	0
11	ZVA DURRES	55	14	69	46	9	55	15	16	31
12	ZVA BULQIZE	27	0	27	15	2	17	0	0	0
	<b>TOTALI</b>	<b>300</b>	<b>166</b>	<b>472</b>	<b>328</b>	<b>50</b>	<b>378</b>	<b>31</b>	<b>59</b>	<b>90</b>



	DRAP Durrës	TOTALI IPAP
1	ZVA MAT	12
2	ZVA KLOS	11
3	ZVA VORE	13
4	ZVA RROGOZHINE	11
5	ZVA KAMEZ	23
6	ZVA KAVAJE	18
7	ZVA DIBER	38
8	ZVA KRUIJE	26
9	ZVA TIRANE	140
10	ZVA SHIJAK	14
11	ZVA DURRES	55
12	ZVA BULQIZE	17
	<b>TOTALI</b>	<b>378</b>



### Sektori i Burimeve Njerëzore Shërbimeve dhe Statistikës në DARP dhe sektori i Shërbimeve në ZVAP , për 8 mujorin 2022 ka realizuar detyra si më poshtë:

- Hartimin e shpërndarjes së fondeve të buxhetit të shtetit për vitin ,të miratuara me ligjin nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2022”,bazuar në kërkesat e sektorëve në realizim të detyrave funksionale.
- Hartimin dhe realizimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike për fondet e alokuara për vitin 2022
- Përgatitja e raportit të **monitorimi të konsoliduar**, të zbatimit të buxhetit për vitin 2021, së bashku me anekset e monitorimit për vitin 2021 të DRAP Durrës dhe 12 ZVAP-et në juridiksion për periudhën Janar – Dhjetor 2021
- Përgatitja e një përmbledhëse vjetore të **Pasqyrave Financiare për vitin 2021** bazuar në PF të 12 ZVAP+DRAP dhe evidentimi i problematikave .
- Bashkëpunim për Përgatitjen e Deklaratës Vjetore** “Për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë për vitin 2021”. Plotësimi i Pyetësorit të vetëvlerësimit për vitin 2021 (pyetjeve të pyetësorit sipas komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (Neni 19, i Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar).
- Bashkëpunimin në hartimin e regjistrit të Riskut për DRAP Durrës 2022
- Raportime në MASR për **detyrimet/ borxhet e krijuara rishtazi për vitin 2022**, si dhe borxhet e mbartura nga viti 2021, si dhe 8-mujorin 2022.
- Raportime në MASR **për detyrimet/ borxhet e krijuara rishtazi nga zbatimi i vendimet gjyqësore** të formës së prerë të likuidura me fonde buxhetore për periudhën vjetore 2021dhe 3 mujori parë 2022 si dhe 8 mujorin 2022.
- Analizë dhe përgatitje e shkresave sipas problematikave të konstatuara.
- Analizë ,përgatitje e autorizimeve dhe likuidimin e shpenzimeve për udhëtime e dieta të punonjësve konform vendimeve të Këshillit të Ministrave;
- Analizë dhe përgatitje e shkresave për fonde për pagesën nga fondi i vecantë të punonjësve të sistemit arsimor konform vendimeve të Këshillit të Ministrave drejtuar MASR dhe likuidimi i tyre nga ana e ZVAP -e;
- Monitorimi i menaxhimit të burimeve njerëzore në institucionet e vartësisë,për punonjësit ndihmës dhe shërbimit psiko-social.
- Raportimi mujor i punonjësve që mbushin moshën për pension për DRAP+12 ZVAP
- Përditësimi i data baze së punonjësve dosjet elektronike te punonjësve DRAP dhe ndjekja e ZVAP-eve
- Ndjekja e procedurave për emërim apo komandim të përkohshëm të drejtuesve të IA,në zbatim të Udhëzimit nr.2, datë 28.01.2020 “Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe të shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar” ,të ndryshuar ,Punonjës të shërbimit psiko-social dh oficerët e sigurisë.
- Marrja e informacionit nga të gjitha IA për numrin e nxënësve, klasave, personelit mësimor .
- Për periudhën Janar-Gusht 2022, janë përgatitur/hartuar dokumentacionin ligjor të përfaqësimit të DRAP ,MAR.DPAP, si autorizime, prapësime, ankime, kundër ankime, për çështjet gjyqësore në të cilët ka qenë palë ndërgjyqëse në vitin 2021-2022, si dhe ankimet/kundër ankimet dhe rekurset/kundër rekurset për çështjet të ndjekura para vitit 2022. Në kuadër të përgatitjes së prapësimeve, sektori ka bashkëpunuar dhe me njësi të tjera në ZVAP
- Sektori ka administruar dosjen e çdo çështjeje gjyqësore të ngritur në vitin 2021-2022, si dhe ka plotësuar në vijimësi të ecurisë gjyqësore të çështjeve të administruara pranë tij, gjithë dokumentacionin që i përket secilës çështje, si vendimin gjyqësor përkatës, ankimin/kunderankimin, rekursin/ kundër rekursin, si dhe dokumentet/akte të tjera të depozituar në cilësinë e provës.
- Sektori ka përfaqësuar dhe vijon përfaqësimin e DRAP në seancat gjyqësore për të gjitha çështjet ku është palë ndërgjyqëse,dhe MAS M dhe DPAP në zbatim të autorizimeve përkatëse.

## **RAPORTIMI 8-MUJOR PËR SEKTORIN E KURRIKULËS DHE ZHVILLIMIT PROFESIONAL**

Sektori së bashku me specialistët e kurrikulës kanë ndjekur trajnime kualifikuese të zhvilluara nga ASCAP apo agjensitë e ndryshme si dhe pjesë e projekteve të zhvilluara nga organizata dhe shoqata që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në fushën e edukimit si p.sh: Eorld Vision etj. Duke u mbështetur në ecurinë e sektorit në vitin e kaluar dhe duke marrë parasysh problemet dhe ndryshimet në arsimin parauniversitar për vitin 2022, u hartua plani i punës në të cilin u përcaktuan SYNIMET, OBJEKTIVAT dhe VEPRIMTARITË me anën e të cilave do të mundësohej realizimi i detyrave të Sektorit dhe plotësimi i kërkesave që dalin nga zbatimi i Ligjit 69/2012 të Arsimit Parauniversitar, Rregullores, Urdhrit Nr.31, datë 28.01.2020 për Miratimin e rregullores për funksionimin e Institucioneve Arsimore të Arsimit Parauniversitar në RSH, Rregullores për funksionimin e Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar si dhe udhëzimeve dhe vendimeve të MAS.

Funksionimi dhe mbarëvajtja e IAP-ve në varësi është përgjegjësi e DRAP dhe ZVAP. Gjithashtu përgjegjësia e institucionit tonë në bashkëpunim me Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar është të sigurohet zbatimi i kurrikulës, metodologjisë dhe standardeve, të vlerësohen nevojat dhe problematikat, të propozohen zgjidhje, të monitorohet kualifikimi i personelit mësimor për kurrikulën, të garantohet ngritja e rrjeteve profesionale, rekrutimi i mësuesve sipas kriterëve të përcaktuara në ligjet dhe udhëzimet e MAS.

### **ZHVILLIMI I VAZHDUESHËM PROFESIONAL I PUNONJËSVE ARSIMORË**

Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i punonjësve arsimorë orientohet dhe rregullohet me dokumentet: ligji nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar, 2014-2020; udhëzimi nr. 1, datë 20.01.2017 “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”; raporti “Identifikimi i nevojave për trajnim të mësuesve dhe të drejtuesve”; urdhri “Për ngritjen e komisionit të akreditimit të programeve të trajnimit”, i ndryshuar. Në legjislacion theksohet se mësuesit dhe drejtuesit trajnohen të paktën 3 ditë në vit dhe se trajnimet zhvillohen sipas sistemit “kërkesë - ofertë”, në bazë të nevojave të mësuesve dhe të ofertave nga agjenci trajnuese të akredituara.

Në kuadër të zhvillimit profesional të mësuesve janë ngritur rrjetet profesionale të mësuesve sipas profileve përkatëse apo sipas roleve të mësuesve në shkollë. Fuqizimi i rrjeteve profesionale të mësuesve ka qenë në vëmendje të veçantë të punës sonë në bashkëpunim të ngushtë me ASCAP-in në procesin e zbatimit të kurrikulës me bazë kompetencat. Rrjetet profesionale të mësuesve për çdo lëndë janë furnizuar në mënyrë të vazhdueshme me materiale mbështetëse, shoqëruar me takime dhe trajnime për zbatimin e tyre.

### **RRJETET PROFESIONALE TË MËSUESVE**

Në zbatim të udhëzimit nr. 16, datë 28.07.2021 për “Organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë” kreu XII neni 34 Rrjetet profesionale çdo ZVAP ka detyrimin që të ngrëjë rrjetin profesional sipas lëndëve, gruplëndëve, shërbimit psiko social, oficerëve të sigurisë etj., me qëllim zhvillimin profesional të punonjësve, të

institucioneve arsimore, përmes informimit këshillimit, trajnimit, shkëmbimit të përvojave dhe mendimeve të anëtarëve të tij për tematika të punës së tyre të përditshme.

Nisur nga kjo detyrë e përcaktuar në udhëzim për vitin mësimor 2021-2022 në ZVAP-et e varësissë së DRAP Durrës janë krijuar dhe kanë funksionuar 371 rrjete profesionale të ndara sipas profileve të mëposhtme:

NR	Rrjete profesionale sipas profileve	DRAP DURRES
1	Arsim Fillor	88
2	Arsim fillor-Klasa kolektive	1
3	Arsim Parashkollor	10
4	Arte	3
5	Bilogji	9
6	Bio-kimi	23
7	Braktisja	1
8	Edukim Fizik	30
9	Edukim Muzikor	4
10	Fizikë	14
11	Filozofi-Sociologji	1
12	Filozofi	1
13	Kimi	3
14	Gjeografi	9
15	Gjuhë e huaj (anglisht, frëngjisht, italisht)	35
16	Gjuhë shqipe dhe letërsi	48
17	Histori	15
18	Histori-gjeografi	16
19	Matematikë	26
20	Matematikë-fizikë	5
21	Matematikë-fizikë-TIK	0
22	Mësues ndihmës	8
23	Ekonomi	2
24	Matematikë-TIK	0
25	Shërbimi Psiko-Social	7
26	Shkenca sociale	2
27	Shkollë qendër komunitare	0
28	TIK	7
29	Arsim special	0
30	N/Drejtor AF	1
31	Drejtorëve	2
	<b>Gjithsej</b>	<b>371</b>

➤ Disa nga tematikat e trajtuara përgjatë periudhës Janar - Dhjetor 2021 kanë qenë:

- Planifikimi ditor dhe vlerësimi i nxënësve sipas nivelit të arritjeve.specifikat e klasave 1-3 dhe 4-5.
- Projekti Kurrikular, hartimi i testit përmbledhës, portofoli i nxënësit, organizimi i orëve të hapura, hartimi i planit vjetor të rrjetit.
- Përdorimi i TIK në modelin e ditarit dhe organizimi i një ore mësimore, metodat e mësimdhënies gjatë mësimimit online.

- Modele të integritit lëndor brenda dhe jashtë fushës së të nxënit.
- Artet dhe edukimi fizik si ndikojnë në zhvillimin e fëmijës
- Diskutim i lëndëve Histori dhe Edukatë Qytetare për një mësimdhënie të suksesshme
- Si të hartojmë një test në google Form, si të përdorim platformën Akademia.al në mësimin në distance. Hartimi i testit sipas arritjeve të Bluprintit. etj

Përsa i përket takimeve të rrjeteve profesionale (në zbatim të nenit 35, të udhëzimit 16) nga informacioni i mbledhur rezultojnë se takimet e tyre zhvillohen një herë në muaj (sipas listëprezencave të paraqitura). Nga drejtuesi i rrjetit planifikohet një temë për trajtim në takimin e radhës. Takimet sipas rëndësisë janë të alternuara fizikisht dhe online (në konsultim me ZVAP).

Gjithashtu Zyrat Vendore Arsimore duhet të kenë të dokumentuar ndarjen e detyrave për specialistët lidhur me rrjetet që ata mbulojnë. Për këtë në vazhdim të punës sonë do të mblidhet informacioni dhe do të ndërtohet plan veprimtarish lidhur me:

- 1- Specialistët e ZVAP-ve të ndarë sipas rrjeteve që ata mbulojnë
- 2- Raportin e vlerësimit për rrjetin profesional që kanë monitoruar (sipas shtojcës 8) në dy kopje ku njëra dorëzohet të drejtuesi i rrjetit dhe tjetra te përgjegjësi i kurrikulës së ZVAP
- 3- Takimet e punës mes specialistit të zyrës dhe drejtuesve të rrjeteve profesionale me focus shkëmbimin e mendimeve apo përmirësimin e cilësisë së veprimtarive të rrjeteve si dhe shkëmbimin e përvojave positive
- 4- Do të mblidhen të dhënat e drejtuesve dhe anëtarëve të rrjeteve profesionale sipas ZVAP-ve.
- 5- Raportet që kanë dorëzuar drejtuesit e rrjetit (të muajve apo vjetor) te specialist.
- 6- Tematikat e trajtuar përgjatë periudhës Janar-Maj 2022

Prioritet i rëndësishëm gjatë këtyre viteve ka qenë dhe do të vazhdojë të jetë mbështetja e arsimit gjithëpërfshirës përmes ngritjes së kapaciteteve të mësuesve ndihmës që tashmë janë pjesë e qenësishme e sistemit tonë arsimor. Puna për këta mësues filloi më krijimin e rrjeteve profesionale të mësuesve ndihmës. Në vazhdimësi do të punohet me monitorimin e punës së rrjeteve profesionale si dhe trajnimet me tematikat më të domosdoshme të kryetarëve të tyre në mënyrë që ata të përhapin eksperiencën e tyre brenda rrjetit.

## **PROVIMI I SHTETIT PËR PROFESIONINERREGULLUARTËMËSUESIT2022**

Në vitin 2022, një ndër veprimtaritë në lidhje me çertifikimin e mësuesve për ushtrimin e profesionit, ka qenë edhe procedura për regjistrimin e tyre për dhënien e provimit të shtetit. Në zbatim të shkresës nr.1451, datë 03.03.2022, "Për zhvillimin e provimit të shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit", gjatë muajit mars u regjistruan për të dhënë provimin e shtetit **1426**kandidatë nga të gjitha ZVAP në varësi të DRAP DURRËS. Më poshtë jepet tabela me rezultatet e ardhura nga QSHA pas përfundimit të provimit sipas profileve.

Nr.	Profili	Të rregjistruar	Pjesëmarrës	Kalues	Jokalues	Mungesa	Nota mesatare	Kalueshmëria në %
1	Arsim fillor	271	215	80	135	56	4.8	37
2	Arsim special	91	86	83	3	5	6.9	96.5
3	Arte Figurative	13	8	6	2	5	5.6	75
4	Biologji	36	25	25	0	11	7.56	100
5	Biologji Kimi	44	27	9	18	17	4.7	33
6	Edukim Fizik	146	122	101	21	24	6.5	83
7	Fizikë	42	32	14	18	10	5.3	44
8	Gjeografi	85	64	43	21	19	6.4	67
9	Gjuhë Angleze	157	130	118	12	27	6.7	90
10	Gjuhë Frënge	22	21	13	8	1	5.7	62
11	Gjuhë Gjermane	16	13	5	8	3	4.8	38
12	Gjuhë Italiane	32	23	13	10	9	5.3	57
13	Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	161	130	103	27	31	6.5	79
14	Gjuhë Turke	1	0	0	0	1	0	0
15	Histori	86	69	50	19	17	6.5	72
16	Histori-Gjeografi	26	17	9	8	9	5.3	53
17	Histori-Gjeografi-Edukatë	6	6	3	3	0	5.6	50
18	Informatikë	10	8	5	3	2	5.4	62

19	Instrumente Muzikore	14	9	7	2	5	6.5	77
20	Kimi	16	14	10	4	2	6.3	71
21	Matematikë	37	28	23	5	9	6.6	82
22	Matematikë-Fizikë	16	13	4	9	3	4.4	31
23	Matematikë-Informatikë	51	42	20	22	9	5.4	48
24	Shkenca Sociale	49	32	21	11	17	5.9	68

Nga analiza e të dhënave, **80%** e tyre e japin këtë provim **për herë të parë**, kurse pjesa tjetër për **herë të dytë 8.8%, të tretë 5.6%, të gjashtë 0.9% dhe të shtatë 0.1%**. Nisur nga kërkesa për dhënien e provimit vihet re se:

Përqindjen më të lartë të aplikimeve i kanë profilet si më poshtë:

o 19% e kandidatëve janë të profilit **”Arsim Fillor”**

o 11.2% e kandidatëve janë të profilit **”Gjuhë Shqipe dhe Letërsi”**

**Nga analiza e rezultateve, vihet re se:**

o**79.4%** e kandidatëve të regjistruar **marrin pjesë në provim**

o**53.5%** e këtyre kandidatëve **janë kalues**

Mbetet problem përqindja e ulët e kalueshmërisë së kandidatëve në provimin e shtetit. Gjykojmë se faktorë ndikues në këtë nivel të ulët kalueshmërie janë:

- Përgatitja e tyre e ulët nga Universitetet ku kanë studiuar.
- Përkushtimi i tyre në ndjekjen me korrektesë të praktikës profesionale.

Për këtë DRAP Durrës në bashkëpunim me ZVAP e varësisë do të monitorojë procesin e organizimit dhe ndjekjes së praktikës profesionale.

### ➤ **PROVIMET KOMBËTARE TË ARSIMIT BAZË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26, nenit 50, pika 1, nenit 50 të ligjit Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe në mbështetje të Udhëzimit Nr.6, datë 04. 04. 2022 “Për zhvillimin e Provimeve Kombëtare të arsimit bazë, në Republikën e Shqipërisë, viti shkollor 2021-2022”; në zbatim të nenit

6 pika 3, të Urdhërit Nr. 72, datë 25.02.2020, “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e Provimit Kombëtar të Arsimit Bazë, në Republikën e Shqipërisë”, janë caktuar datat e PKAB si më poshtë:

- **Gjuhë Shqipe 20 Qershor 2022**
- **Matematikë 23 Qershor 2022**
- **Gjuhë e huaj 29 Qershor 2022**

Për lëndën Gjuhë Shqipe dhe Letërsi janë parashikuar 14581 nxënës pjesmarrës.

Për lëndën Matematikë janë parashikuar 14581 nxënës.

Për lëndën e Anglishtes janë parashikuar 11698 nxënës.

Për lëndën Frëngjisht janë parashikuar 1962 nxënës.

Për lëndën Italisht janë parashikuar 819 nxënës.

➤ Përfaqësues të DRAP Durrës monitoruan procesin e hedhjes së shortit për shpërndarjen e PAP-ve, AP-ve dhe AS-ve në qendrat e provimeve, në ZVAP-të nën juridiksionin e DRAP Durrës, si dhe dhe procesin e zhvillimit të provimit në Qendrat e Provimit të përzgjedhura me kampinim. Nga raportimet e monitoruesve që DRAP Durrës ka autorizuar rezulton se janë **155** qendra provimi.

ZVAP	Nr. i qendrave të provimit si ZVAP	Nr. i shkollave si ZVAP	Nr. i nxënësve të regjistruar për provim si ZVAP	Nr. i nxënësve pjesëmarrës në provim si ZVAP	Nr. i nxënësve të munguar në provim si ZVAP	Nr. Total PAP	Nr. Total AP	Nr. Total AS	Nr. Total PK
<b>TOTAL</b>	<b>155</b>								

Procesi është zhvilluar konform rregullores dhe nuk ka patur problematika. DRAP në bashkëpunim me ZVAP me mbylljen e sesionit të II-të të PKAB do të analizojë rezultatet e këtyre provimeve për të dalë me sugjerime mbi arritjet dhe problematikat nëse ka në rezultate duke patur në fokus rritjen e cilësisë së arsimit bazë.

## I. ECURIAENISMËS“SHKOLLASIQENDËRKOMUNITARE”

Nisma “Shkolla si Qendër Komunitare”, filloi zbatimin e saj në vitin 2014 dhe prej asaj kohe deri tani ka pasur një rritje të interesit të shkollave për t’u bërë pjesë në këtë nismë. Shkolla Qendër Komunitare (ShQK) është një model promovues dhe zhvillues për ta kthyer shkollën në vendin ku ndërtohet partneriteti shkollë-familje-komunitet dhe bashkëpunohet për zhvillimin e potencialit të plotë të çdo nxënësi.

Në vitin 2021, në DRAP Durrës , funksionuan 70 Shkolla si Qendër Komunitare (SHQK).

**34.2%** në arsimin e mesëm të lartë (AML)

**65.7%** në arsimin e mesëm të ulët (AMU)

□ **62.8%** në qytet

DRAP	ZVAP		2014-2015	2015-2016	2016-2017	2017-2018	2018-2019	2019-2020	2020-2021	2021-2022
DURRËS		TOTAL-SHKOLLA QENDER KOMUNITARE(SHQK)	14	56	58	58	69	70	70	115
<b>DURRËS</b>		<b>SHQK-AML</b>	<b>7</b>	<b>21</b>	<b>21</b>	<b>21</b>	<b>23</b>	<b>24</b>	<b>24</b>	<b>33</b>
DURRËS		SHQK -AML QYTET	3	17	17	17	17	18	18	21
DURRËS		SHQK -AML FSHAT	4	4	4	4	6	6	6	12
DURRËS		NXENES-AML PERFITUES	1910	17511	16736	16543	17468	17854	17711	2444
DURRËS		PRINDER-NX.AML PERFITUES	3210	28334	30061	30605	10473	31354	30890	
DURRËS		MESUES-AML PERFITUES	15	634	662	664	233	348	354	
<b>DURRËS</b>		<b>SHQK-AMU</b>	<b>7</b>	<b>35</b>	<b>37</b>	<b>37</b>	<b>46</b>	<b>46</b>	<b>46</b>	<b>82</b>
DURRËS		SHQK -AMU ZONE QYTET	6	22	23	23	26	26	26	40
DURRËS		SHQK -AMU ZONE FSHAT	1	13	14	14	20	20	20	42
DURRËS		NXENES-AMU PERFITUES	1978	19009	18246	18145	21582	23480	22513	15635
DURRËS		PRINDER-NX.AMU PERFITUES	1790	25675	26060	26428	27785	30192	28834	
DURRËS		MESUES-AMU PERFITUES	80	499	486	507	666	422	413	

□ **37.2%** në fshat

□ **17711** nxënës janë përfitues të veprimtarive dhe shërbimit që ofrohet në këto shkolla

□ **30890** prindër të nxënësve të shkollës janë përfitues nga shërbimet në këto shkolla

□ **354** mësues ofrojnë shërbimin dhe janë përfitues në këto shkolla

Tabela e mëposhtme tregon ecurinë 8vjeçare të kësaj nisme me të dhënat për të gjitha vitet sipas treguesve. Në vitin 2021-2022, në DRAP Durrës, funksionojnë 115 Shkolla si Qendër Komunitare (SHQK). Të gjithë partnerët dhe aktorët e SHQK por në veçanti shkollat duhet të punojnë duke u udhëhequr fort nga *parimi që të kemi shkolla qendër komunitare dhe jo thjesht të flasim për Shkolla Qendër Komunitare.*

DRAP		2014-2015	2015-2016	2016-2017	2017-2018	2018-2019	2019-2020	2020-2021	2021-2022
DURRËS	<b>TOTAL-SHKOLLA QENDER</b>	<b>14</b>	<b>56</b>	<b>58</b>	<b>58</b>	<b>69</b>	<b>70</b>	<b>70</b>	<b>115</b>



<b>DRAP DURRËS PËRFITUES FËMIJË</b>			
<b>NXËNËS</b>	<b>Femër</b>	<b>Mashkull</b>	<b>Total</b>
<b>Nxënës me AK</b>	<b>80</b>	<b>178</b>	<b>258</b>
<b>Nxënës nga komuniteti rom&amp;egjyptian</b>	<b>152</b>	<b>170</b>	<b>322</b>
<b>Nxënës të tjerë</b>	<b>7961</b>	<b>6671</b>	<b>14632</b>
<b>Total</b>	<b>8193</b>	<b>7019</b>	<b>15212</b>

1. Fusha në të cilat janë fokusuar veprimtarite e shkollave dhe përfshirja e komuniteteve në to, prezantohen në tabelën e mëposhtme.

<b>FUSHAT</b>	
<b>FUSHA:1.</b>	<b>Sigurimi i arsimit cilësor për çdo nxënës</b>
<b>FUSHA:2.</b>	<b>Sigurimi i mirëqenies sociale, emocionale, shëndetësore të nxënësve</b>
<b>FUSHA:3.</b>	<b>Angazhimi dhe zhvillimi i komunitetit</b>
<b>FUSHA:5.</b>	<b>Gjithëpërfshirja dhe respektimi i diversitetit</b>

2. Cilat ishin ndikimet pozitive të “ Shkollës qendër komunitare” tek:

• **Prindërit:**

- Përfshihen personalisht në aktivitetet e fëmijëve dhe vlerësojnë talentin e tyre nga afër.
- Informohen në mënyrë të vazhdueshme për arritjet e gjithanshme të fëmijëve.
- Bashkëpunojnë me stafin e shkollës për të njohur stilet e të nxënësve të nxënësve.

• **Nxënësit:**

- Zhvillohet shpirti human i nxënësve.
- Informohen rreth zhvillimeve sociale të ndryshme të komunitetit.
- Përfaqësojnë në mënyrë dinjitoze shkollën dhe veten në aktivitete sportive.
- Shpalosin talentin e tyre.
- Motivohen për të arritur suksesin e dëshiruar.
- Ky proces ka ushqyer të qenit bashkëpunues dhe bashkëpunues në realizimin e detyrave.
- Shumë nga veprimtaritë kanë ndihmuar nxënësit për të përmirësuar rezultatet e tyre, kryesisht nxënësit me vështirësi në të nxënë.

• **Komuniteti:**

- a) Aktivitetet sportive, kulturore dhe argëtuese kanë gjallëruar jetën e komunitetit.
- b) Veprimtari me fokus mjedisin kanë ndihmuar në përmirësimin e kushteve ku ata jetojnë .

- c) Në imazhin e institucionit arsimore ndjehet impakti i marrëdhënies shkollë – komunitet .
- d) Idetë dhe angazhimi i komunitetit ka ndihmuar shkollën për të patur më të qartë krijimin e një shkolle vizionare
- e) Shkolla ofron ndihma për komunitetin.
- f) Nxënësit rrisin shpirtin e bashkëpunimit me komunitetin.
- g) Komuniteti jep ide për rritjen e performancës së nxënësve.

### 3. Sfidat për të ardhmen

- Rritja e numrit të nxënësve dhe prindërve pjesëmarrës në veprimtaritë e “ Shkollës Qendër Komunitare”
- Ndërtimi i një imazhi të besueshëm dhe të vlerësuar nga komuniteti me qëllim përfshirjen më të madhe të tij.
- Ndërgjegjësimi me i madh i komunitetit për të mbështetur aktivitetet të organizuara nga SHQK.
- Gjetja e donatorëve apo sigurimi i mbështetjes nga OJF në implementimin e projekteve.
- **Më shumë pjesëmarrës dhe aktivitete.**
- Zhvillimi i procesit mësimor-edukativ në një shkollë tjetër dhe në turnin e pasdites.
- Mungesa e mjediseve fizike.
- Probleme me bazën materiale digjitale të IT dhe internetit në shkolle.

Angazhimi dhe zhvillimi i komunitetit, duke ofruar kurse, shërbime dhe mjedise fizike.

Nisur nga investimet e bëra në mjediset fizike të shkollave (ndikuar edhe nga problemet e krijuara nga tërmeti i Nëntorit 2019) ka patur kërkesa nga ZVAP-të që të shtohen shkollat të reja në nismën SHQK. Për këtë po punohet në mënyrë që të vlerësohen shkollat të cilat plotësojnë standartet sipas formularit të treguesve të shkollave SHQK dhe me marrjen e miratimit të MAS natyrisht do të kemi një numër të shtuar të tyre për vitin mësimor 2022-2023.

Puna jonë do të fokusohet në ndjekjen e veprimtarisë së shkollave SHQK me qëllim unifikimin e mënyrës së planifikimit sipas fushave, hartimit të veprimtarive të SHQK në përputhje me kushtet e shkollës, raportimit të realizimeve dhe përmbushjes së objektivave. Për këtë do të bëhen trajnime me të gjithë koordinatorët SHQK të shkollave dhe ZVAP-ve

#### **PORTALI “MËSUES PËR SHQIPËRINË” 2022-2023 PJESËMARRJA, VLERËSIMI**

Udhëzimit nr.12, datë 10.06.2021 “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar”, shkresa Nr.1567/1 prot, datë 05.04.2022 të MAS Për një ndryshim të afateve për procedurat e konkurrimit të mësuesve në portalin “Mësues për Shqipërinë” 2022, Shkresa Nr.697/1 prot, datë 14.04.2022 të DPAP për procedurat e konkurrimit të mësuesve në portalin “Mësues për Shqipërinë” 2022, është realizuar procesi i vlerësimit të kandidatëve aplikantë në portal. Nga database e të dhënave kemi këtë përmbledhje

- 1-Aplikante gjithsej në DRAP Durrës
- 2-Aplikante që kanë dorëzuar dosjen fizike **4612**
- 3-Aplikante që kanë hyrë në testim **2188**

4-Skualifikime gjithsej **128** nga të cilat **18** kanë mosaplikim online dhe 110 mungesa në dokumenta sipas përcaktimeve të udhëzimit 12 ose aplikim jo sipas profilit.

5-Numri i ankesave të trajtuara për **fazën e I** ishte mbi **400**.

Nr	PROFIL	APLIKIME	SKUALIFIKIME	HYJNË NË TESTIM
1	Arsim fillor	411	33	245
2	Arsim parashkollor	206	17	146
3	Arsim Special	67	1	63
4	Art Pamor	6	5	1
5	Art Pamor (SK)	29	1	19
6	Balet	2	0	1
7	Biologji	236	6	134
8	Edukim Fizik	220	3	166
9	Fizikë	83	3	42
10	Gjeografi	337	8	168
11	Gjuhë Angleze	343	7	241
12	Gjuhë Frënge	68	1	47
13	Gjuhë Gjermane	26	1	13
14	Gjuhë Italiane	65	3	35
15	Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	629	10	369
16	Histori	319	5	176
17	Kimi	116	2	65
18	Matematikë	247	8	148
19	Muzikë	26	6	11
20	Muzikë (SK)	44	1	33
21	Shkenca Sociale	102	7	55
22	TIK	12	1	9

Siç duket edhe nga të dhënat, **profili më i kërkuar** është ai i **"Gjuhës shqipe dhe letërsisë"**, në të cilin janë rreth **629** kërkesa; mëpas renditet profili **"Arsim Fillor"** me **411** kërkesa dhe **"Matematikë"** me **347** kërkesa.

#### **Problematika të Portalit.**

- 1- Libreza e punës në shumë raste e pa mbyllur kur kandidati rezulton i papunë në momentin e aplikimit apo dorëzimi i saj në dosjen fizike dhe online.
- 2- Përgjigjet e vonuara nga zyrat për Librezat e hapura, për arsye të verifikimeve të kandidatëve që kërkoreshin (Kjo ka rritur dhe numrin e ankimeve sepse nuk e kanë të depozituar në dosje librezën por dhe ka bllokuar punën tonë për mbylljen e vlerësimit të dosjes nga sekretaria teknike)
- 3- Mos aplikimi online për probleme të sistemit. Për këtë rihapja e sistemit dhe riaplikimi për kandidatët nga KVD shtoi volumin e punës, ngarkesën jashtë orareve për të arritur në kohë shpalljen e rezultateve.
- 4- Mungesa e një specialisti IT në sektorin e SKZHP për specifika të portalit por jo vetëm.

## **II. PRAKTIKAPROFESIONALEEKANDIDATËVEPËRUSHTRIMINEPROFESIONIT TËMËSUESIT PËR VITIN SHKOLLOR 2021-2022**

Në zbatim të Urdhërit nr. 336, datë 14.07.2011,për "Miratimin e Rregullores për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit", indryshuar u përcaktuan procedurat për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit. ZVAP ka shpërndarë

praktikantët në IAP që plotësojnë kriteret me mentorët sipas vlerësimit të dosjeve.  
Tabela më poshtë tregon numrin e praktikantëve për ZVAP përkatëse

				7	Durrës	Klos	65
1	Durrës	Bulqizë	47	8	Durrës	Mat	79
2	Durrës	Dibër	49	9	Durrës	Shijak	58
3	Durrës	Durrës	137	10	Durrës	Rrogozhinë	64
4	Durrës	Kamëz	150	11	Durrës	Tiranë	668
5	Durrës	Kavajë	23	12	Durrës	Vorë	31
6	Durrës	Krujë	112				

Në Shkurt të vitit 2022 me Urdhërin Nr.100, datë 25.02.2022, me nr.1305/1prot datë 25.02.2022, Urdhërohet

1. Miratimi i Rregullores për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit.
2. Urdhri Nr.336, datë 14.07.2011 për “Miratimin e Rregullores për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit” shfuqizohet.

Sipas përcaktimeve të këtij urdhri koha e realizimit të praktikës profesionale është shkurtuar dhe është e barazvlefshme dhe mund të zhvillohet në një nga periudhat mësimore sipas ndarjes Shtator-Dhjetor, Janar-Mars dhe Prill-Qershor. Për këtë janë mbledhur dhe publikuar në faqen zyrtare IPAP-të ku mund të zhvillohet praktika profesionale dhe po ndiqet procesi i regjistrimit, krijimit të databazës dhe shpërndarja e kandidatëve në shkollat e zgjedhura.

## KUALIFIKIMI I MËSUESIT 2021-2022

### Pjesëmarrja e mësuesve

Zhvillimi profesional i mësuesve është një nga detyrat themelore të punës për DRAP Durrës, Në bashkëpunim me ASCAP dhe ZVAP është organizuar puna për realizimin e procesit të kualifikimit të mësuesve për vitin 2021-2022, duke u ngritur grupet e punës dhe duke u orientuar të gjitha ZVAP për të vlerësuar me korrektësi portofolin personal dhe profesional të mësuesve. Kualifikimi i mësuesve për vitin 2022 u mbështet në Udhëzimin udhëzimit nr.4 datë 26.02.2021 “ Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve. Monitoruam me urdhër dhe platformë monitorimi ZVAP Tiranë, Vorë, Mat, Durrës, Krujë. Nga kontrolli i dosjeve me kampionim në secilën prej zyrave rezultoi se janë zbatuar përcaktimet sipas udhëzimit përkatës. Janë konstatuar disa gabime në pjesën e përfutur të bonuseve gjuhë e huaj dhe master passhkollimi për të cilat në bashkëpunim me institucionet përkatëse eprore dhe të varësisë janë marrë masa që të korrigjohen në kohë gabimet e konstatuara.

- Numri i mësuesve të DRAP Durrës që morën pjesë në kualifikim është 1033 kandidatë dhe numri i mësuesve të cilët u futën në kualifikim ishte 960 kandidatë Tabela e mëposhtme pasqyron rezultatet për çdo ZVAP për të gjitha profilet.

- Pjesëmarrjet madhekanëmësuesit që japin mësim në nivelin e simit bazë në AMU.

NR	ZVAP në varësi	Nr. i mësuesve pjesëmarrës	Lëndët																																	
			AF	APS	AS	B	E	M	PA	E	FIZ	MUZ	F	Q	S	FL	P	GJ	GJA	GJF	GJ	GJ	GJ	SHL	H	K	M	TIK	L	BA	M	MUZ	SK	SK	Akron	Përsht
1	Bulqizë	24	8	1		3			1		1					1	1	3					1	1		2	1								AF	Arsimi
2	Dibër	34	3	4		4			2		2						2	5																	AP	Arsimi
3	Durrës	162	34	12		8		2	19		5	1	1				12	17	4			3	14	10	2	12	1			1	4			APSH	Arsimi	
4	Kamëz	74	16	3		6			6		5						1	8	1	1			13	4	2	8								AS	Arsimi	
5	Kavajë	35	5	5					1		0	1					5	3	2				7	2		4								B	Biologji	
6	Klos	15	3	2					1		0						1	0				1	5	1	1	1								E	Ekonomi	
7	Krujë	49	5	7		1			6		1						4	5	1				7	2	6	4								PAM	Art Pa	
8	Mat	14	3	0		0			2		1						1	1					3	1	1	1								EFIZ	Edukimi	
9	Rrogozhinë	26	6	0		4			1		0			1			1	3					3	4		3								MUZ	Muzikë	
10	Shijak	17	7	2		0			1		0						3	2	8				1			1									F	Fizikë
11	Tiranë	492	87	53	7	15	1	8	49	9	18	5	1				19	49	1	2	11	62	24	13	35	1	2	2	2				Q	Qyteta		
12	Vorë	18	3	0		1			1								3	4					4			1								S	Sociok	
	<b>Total</b>	<b>960</b>	<b>180</b>	<b>89</b>	<b>7</b>	<b>42</b>	<b>1</b>	<b>10</b>	<b>90</b>	<b>9</b>	<b>33</b>	<b>7</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>53</b>	<b>100</b>	<b>17</b>	<b>3</b>	<b>16</b>	<b>126</b>	<b>54</b>	<b>25</b>	<b>72</b>	<b>3</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>6</b>	<b>952</b>	<b>FL</b>	<b>Filozof</b>					
	Pjesëmarrës	1033																																		
	Skualifikuar	3																																		

Vihet renumrimë i madhikandidatëve që kanë kërkuar të fitojnë kategorinë të tretë (Mësuesi kualifikuar), 45% etë gjithë kandidatëve

### REZULTATE TË TESTIMIT 2022

NR.	DRAP	Nr. mësuesve pjesëmarrës	Nr. Ankimeve për testin	Rezultate 2022					Rezultate 2022 në %					Total në %
				A	B	C	D	E	A	B	C	D	E	
	Total	960	98	46	408	432	45	26	4.7	42.5	45	4.6	2.7	99.5%

Sipas rezultateve kemi një përqindje 47.2% të mësuesve që kanë marrë vlerësimin Shkëlqyeshëm dhe Shumë Mirë. Në nivel DRAP

### Rezultati në shifra i Kualifikimit të mësuesit 2021-2022

NR.	ZVAP në varësi	Nri regjistrimeve nga ZVAP	Nr. i mësuesve pjesëmarrës	Nr. i Ankimeve për testin	Rezultate 2022				
					A	B	C	D	E
1	Bulqizë	26	24	1	0	1	20	2	1
2	Dibër	34	34	7	0	5	23	2	3
3	Durrës	167	162	19	7	79	66	6	4
4	Kamëz	77	74	5	1	22	42	6	3
5	Kavajë	35	35	5	2	15	17	0	1

6	Klos	16	15	3	0	4	10	1	0
7	Krujë	50	49	6	3	12	28	2	3
8	Mat	15	14	5	0	5	8	1	0
9	Rrogozhinë	27	26	3	0	7	17	1	1
10	Shijak	17	17	0	0	8	6	2	1
11	Tiranë	551	492	44	32	242	187	21	9
12	Vorë	18	18	0	1	8	8	1	0
	<b>Total</b>	<b>1033</b>	<b>960</b>	<b>98</b>	<b>46</b>	<b>408</b>	<b>432</b>	<b>45</b>	<b>26</b>

### Vlerësimi dhe arritjet e mësuesve

#### Arritjet mesataresipasnivelevearsimore

- **Mësueset e arsimit fillor (AF), kanë rezultatet më të ulëta (Mirë, Mjaftueshëm dhe Dobët) në arritjet e përgjithshme, me 58.4%, kundrejt të gjitha niveleve të tjera Shkëlqyeshëm dhe Shumë Mirë. Rezultate më të larta kanë mësuesit e Arsimit Special dhe shkollat Artistike të cilat nuk kanë asnjë vlerësim Mjaftueshëm dhe Dobët**

Në tabelën e mëposhtme, tregohet në përqindjesh për ndarja e mësuesve të çdoniveleve arsimor, sipas shkallës së vlerësimit që ka marrë:

#### Rezultate e kualifikimit të shprehur në % sipas ciklit arsimor

Vlerësimi	APSH	AF	AMU	AML	AS/ASK
A	3.3%	2.2%	3.8%	7.4%	20%
B	47.1%	38.8%	39.6%	48.5%	56%
C	40%	52.4%	48.2%	35.6%	24%
D	3.3%	4.4%	4.5%	5.4%	0%
E	4.4%	1.6%	3.2%	2.9%	0%

#### ➤ **NDJEKJA E PROCESIT TË ORGANIZIMIT TË FAZËS SË PARË, FAZËS SË DYTË DHE TË TRETË TË OLIMPIADAVE KOMBËTARE PËR VITIN 2020-2021. MIRATIMI I KOMISIONEVE TË ADMINISTRIMIT DHE VLERËSIMIT TË TESTIT.**

- **Bazuar Udhëzimit Nr. 24, datë 23.01.2020 "Për miratimin e rregullore për zhvillimin e Olimpiadave Kombëtare në arsimin parauniversitar dhe pjesëmarrjen e nxënësve në Olimpiadat Kombëtare u zhvillua:**

**Monitorim i ZVAP-ve në zbatimin e udhëzimeve MASR-së dhe rregullore për organizimin e olimpiadave në ZVAP-të. Me prioritet kanë qenë ZVAP-të me numër më të madh nxënësish pjesëmarrës si: Tiranë, Durrës, Kamëz, Rrogozhinë.**

➤ **Ndjekja e procesit të organizimit të Fazës së Parë të Olimpiadave Kombëtare për vitin 2021-2022. Miratimi i komisioneve të administrimit dhe vlerësimit të testit.**

a. Janë zhvilluar olimpiadat në të gjitha lëndët ku kemi fituesit sipas tabelës së mëposhtme:

DRAP Durrës	Nxënës pjesëmarrës	Nxënës fitues	Institucioni arsimor		Klasa							
			Publik	Privat	10	11	12	9	8	7	6	5
Matematikë AMU	206	8	6	2				8				
Matematikë AML	268	27	13	14	11	9	7					
Fizikë	205	26	8	18	6	8	12					
Kimi	233	29	14	15	9	9	11					
Biologji	331	62	20	42	25	9	28					
Gjuhë shqipe dhe letërsi	574	178	114	64	53	68	57					
Informatikë	131	47	26	21	12	23	12					
Histori	177	32	14	18	14	15	3					
Gjeografi	184	49	22	27	30	14	5					
<b>Total</b>	<b>2309</b>	<b>458</b>	<b>237</b>	<b>221</b>	<b>160</b>	<b>155</b>	<b>135</b>	<b>8</b>				

**Monitorim i ZVAP-ve në zbatimin e udhëzimeve MAS dhe regullores për organizimin e olimpiadave në ZVAP-të e varësisë. Me prioritet kanë qenë ZVAP-të me numër më të madh nxënësish pjesëmarrës si:**

- |           |           |
|-----------|-----------|
| a. Tiranë | d. Kamëz  |
| b. Durrës | e. Kavajë |
| c. Krujë  |           |

**Fituesit e fazës së dytë të Olimpiadës Kombëtare.**

			Nxënës pjesëmarrës	Nxënës fitues	Institucioni arsimor		Klasa		
1	<b>DRAP Durrës</b>	Klos	8	0	0				
2		Kamëz	87	30	30		7	7	16
3		Kavajë	8	1	1				1
4		Vorë	9	5	5	0	1	4	
5		Bulqizë	19	0	0				
6		Dibër	32	1	1			1	
7		Krujë	45	1	1		1		
8		Mat	26	14	14		5	7	2
9		Rrogozhinë	49	3	3			2	1
10		Durrës	165	66	25	41	21	30	15
11		Shijak	1	0	0				
12		Tiranë	486	138	70	68	62	46	30
	<b>Gjithsej</b>		<b>935</b>	<b>259</b>	<b>150</b>	<b>109</b>	<b>97</b>	<b>97</b>	<b>65</b>

**Ndjekja e procesit të organizimit të Fazës së Tretë të Olimpiadave Kombëtare për vitin 2021-2022. Miratimi i komisioneve të administrimit dhe vlerësimit të testit.**

- b. Janë zhvilluar olimpiadat në të gjitha lëndët ku kemi fituesit sipas tabelës së mëposhtme:

	DRAP Durrës	Nxënës fitues	Institucioni arsimor		Klasa			
			Publik	Privat	10	11	12	9
1	Matematikë AMU							
2	Matematikë AML	2		2			2	
3	Fizikë	8	3	5	2	1	5	
4	Kimi	5	3	2	1		4	
5	Biologji	27	6	21	3	6	18	
6	Gjuhë shqipe dhe letërsi	9	3	6	4		5	
7	Informatikë	8	5	3	2	1	5	
8	Histori	6	3	3	3	3		
9	Gjeografi	6	2	4	5		1	
	<b>Total</b>	<b>71</b>	<b>25</b>	<b>46</b>	<b>20</b>	<b>11</b>	<b>40</b>	<b>0</b>

➤ **MATURA SHTETËRORE 2021-2022**

- 1- Në zbatim të Urdhrit Nr 108, dt. 4.3.2022, të MASR - "Për miratimin e rregullores për zhvillimin e Maturës Shtetërore 2021-2022 në Republikën e Shqipërisë" janë përcaktuar në bashkëpunim me ZVAP-të dhe DPAP-në qendrat e zhvillimit të provimit të Maturës Shtetërore si më poshtë:

<b>QENDRAT E MATURËS SHTETËRORE 2021-2022</b>				
NR	DRAP	ZVAP	QENDRA PROVIMI	TOTAL NUMRI I NXËNËSVE
1	<b>DURRËS</b>	Bulqizë	1	245
2	<b>DURRËS</b>	Dibër	2	537
3	<b>DURRËS</b>	Durrës	12	2898
4	<b>DURRËS</b>	Kamëz	6	1450
5	<b>DURRËS</b>	Kavajë	1	305
6	<b>DURRËS</b>	Klos	1	114
7	<b>DURRËS</b>	Krujë	3	553



8	<b>DURRËS</b>	Mat	1	258
9	<b>DURRËS</b>	Rrogozhinë	1	137
10	<b>DURRËS</b>	Shijak	1	142
11	<b>DURRËS</b>	Tiranë	31	1945
12	<b>DURRËS</b>	Vorë	2	266
<b>TOTAL DRAP</b>			62	<b>8850</b>

Për mbarëvajtjen e procesit të organizimit të provimeve të MSH janë organizuar trajnime me personat përgjegjës të administrimit të provimit sipas detyrave të përcaktuara në rregullore. Për këtë është mbledhur grafiku i organizimit të trajnimeve sipas ZVAP-ve dhe janë siguruar material në ndihmë të trajnimit nga QSHA, DPAP dhe DRAP.

Gjithashtu nga informacionet e marra në rrugë zyrtare rezulton se të gjitha gjimnazet kanë hartuar grafikun e konsultimeve sipas lëndëve i cili është miratuar nga Drejtori I ZVAP dhe është publikuar në këndin e Maturës Shtetërore të shkollës. (Sipas raportimit dhe monitorimit të ZVAP).

Pas daljes së rezultateve nga QSHA do të përgatiten dhe statistikat në nivel DRAP dhe ZVAP që kemi në varësi për të krahasuar dhe nxjerrë objektivat e punës në vazhdimësi.

### ***NXËNËSITKANDIDATËPËR“MEDALJENEARTË”***

Mbështetur në Udhëzimit nr. 7. datë 08.04.2021, "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së medaljes së artë", për vitin 2021-2022 u shpallën kandidatë fitues të "Medaljes së Artë", nxënësit e mëposhtëm:

<b>ZVAP</b>	<b>TOTAL</b>	<b>PUBLIK</b>	<b>PRIVAT</b>
TIRANË	31	19	12
DURRËS	4	1	3
KAVAJË	1	1	
KRUJË	1	1	
BULQIZË	1	1	

## Mbi zhvillimin e aktiviteteve dhe punën e zhvilluar me fokus braktisjen shkollore.

Pas kërkesës ZVAP-ve për informacion u bë grumbullimi i tyre tabelore dhe narrative ku, Institucionet Arsimore Parauniversitare të ZVAP-ve në varësi të DRAP Durrës kanë trajtuar fenomenin e braktisjes shkollore me synimin për të reduktuar numrin e nxënësve në rrezik braktisjeje të shkollës, bazuar në informacione dhe burime të ndryshme, mekanizma zyrtare dhe jozyrtare dhe kanë analizuar shkaqet kryesore që i kanë bërë këto nxënës të braktisin shkollë. Institucionet Arsimore e kanë hartuar plane vjetore ku përfshihen veprimtari të ndryshme.

### **RAPORTIM PËR CEDAË**

#### **(KOMITETIT PËR ELIMINIMIN E DISKRIMINIMIT KUNDËR GRAVE**

- masat e marra për heqjen/eliminimin e tarifave të shkollimit;
- aplikimi i alfabetit Braille dhe gjuhës së shenjave për të rritur numrin e regjistrimeve dhe përfundimit të shkollës për vajzat rome dhe egjiptiane, vajzat dhe gratë me aftësi të kufizuara dhe ato që jetojnë në zona rurale, në të gjitha nivelet e arsimit;
- masat që janë marrë për të siguruar rritjen e aksesit për zhvillimin e karrierës për vajzat dhe gratë, veçanërisht në fushën e shkencës, teknologjisë, inxhinierisë dhe matematikës (STEM) dhe teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), *(për institucionet e varësisë të përcjellin informacion për projektet ku përfshihen gratë në STEM dhe TIK)*;
- programet dhe aktivitetet e organizuara për të mësuar dhe zhvilluar kapacitetin e vajzave dhe grave me aftësi të kufizuara;
- shkallën e braktisjes së shkollimit, të ndara sipas përkatësisë etnike, seksit, racës, moshës, statusit socio-ekonomik dhe vendndodhjen gjeografike;
- masat e marra për të adresuar zgjidhjen e këtyre problematikave

#### **Provimet VANAF**

○ Udhëzimit Nr. 6, datë 31.3. 2021 “Për zhvillimin e vlerësimit të arritjeve të nxënësve të arsimit fillor, viti shkollor 2020-2021”; Urdhërit Nr. 78, datë 27.02.2020, “Për miratimin e rregullores për procedurat e organizimit dhe zhvillimit të Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve të Arsimit Fillor”, Urdhërin Nr. 75, datë 18. 05. 2021 “Për monitorimin e procesit të zhvillimit të Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve të Arsimit Fillor”, me datën 21.05.2021, u zhvillua testimi i nxënësve të klasave të pesta “Për zhvillimin e Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve të Arsimit Fillor, viti shkollor 2020-2021”.

○ Edhe procesi i provimeve të VANAF u monitorua me pëfaqësues të DRAP Durrës që nga hedhja e shortit për shpërndarjen e PAP-ve, AP-ve dhe AS-ve në qendrat e provimeve, në ZVAP-të nën juridiksionin e DRAP Durrës, si dhe dhe procesin e zhvillimit të provimit në Qendrat e Provimit të përzgjedhura me kampionim.

➤ Nga raportimet e monitoruesve që DRAP Durrës ka autorizuar rezulton se janë 203 qendra provimi dhe 420 shkolla pjesëmarrëse. Nxënës të regjistruar për zhvillimin e provimit janë 14829 nxënës. Të dhënat sipas tabelës së mëposhtme:

<b>DRAP</b>	<b>Nr. i qendrave të provimit</b>	<b>Nr. i shkollave pjesëmarrëse</b>	<b>Nr. i nxënësve pjesëmarrës në provim për çdo qendër</b>	<b>Problematika që dolën gjatë procesit</b>
DURRËS	203	420	14829	Nuk ka probleme

## NISMA “BËJMË DETYRAT E SHTËPISË NË SHKOLLË”

Nisma “Bëjmë detyrat e shtëpisë” është një program, i cili u ofrohet të gjithë nxënësve të institucioneve arsimore në të cilat zbatohet kjo nismë.

Ky program është në zbatim të Urdhërit nr. 811, datë 14.12.2018, “Për miratimin e udhëzuesit për zbatimin e nismës “Bëjmë detyrat e shtëpisë” dhe synon:

- sigurimin e kushteve dhe të mundësive të barabarta për nxënie për të gjithë nxënësit dhe krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës që mbështet dhe nxit progresin e çdo fëmije;
- përmirësimin e arritjeve të nxënësve, përmes sigurimit të kohës, hapësirës dhe programeve shtesë që ofrohen pas mësimin për të gjithë nxënësit, duke i ndihmuar ata në kryerjen e detyrave të shtëpisë;
- nxitjen dhe zhvillimin e interesave dhe prirjeve të nxënësve në fusha të caktuara përmes aktiviteteve jashtë kurrikulare që organizon shkolla;
- përmirësimin e klimës dhe zhvillimin e frymës së bashkëpunimit në shkollë;
- mbështetjen e familjeve dhe zhvillimin e partneritetit me prindërit dhe anëtarë të tjerë të komunitetit, për t’iu përgjigjur sa më mirë përmbushjes së nevojave fizike, emocionale dhe sociale të nxënësve, si dhe për të garantuar zhvillimin e tyre të shëndetshëm.

Përgjatë vitit shkollor 2021-2022, nisma “Bëjmë detyrat e shtëpisë” u pilotua në 8 Zyra Vendore të Arsimit parauniversitar me përfshirjen e 43 institucioneve arsimore parauniversitare (IAP)

Gjithashtu nga IZHA është hartuar udhëzuesi për zbatimin e nismës “Bëjmë detyrat e shtëpisë”, i cili është një material ndihmës për institucionet arsimore dhe institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të përfshira në zbatimin e nismës.

### 3.8 - Sektori i Inspektimit dhe Vlerësimit të Cilësisë në DRAP Durrës

Sektori i Inspektimit dhe Vlerësimit të Cilësisë në DRAP Durrës për vitin 2022, në zbatim të Ligjit 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr.99, datë 27.02.2019 " Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar ", urdhërit nr.68, datë 05.04.2019, për "Miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme dhe Drejtorive Rajonale të Arsimit Parauniversitar", "Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar" me nr.4699/1 prot, datë, 30.04.2019, ka kryer inspektime në institucionet arsimore të sistemit parauniversitar në juridiksion të saj.

Theksojmë se qëllimi i inspektimeve, të realizuara, ka qenë dhe është verifikimi i funksionimit të IA dhe ZVAP në raport me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe ndikim në cilësinë e menaxhimit të brendshëm të tyre.

Konkretishtë inspektimet me natyrë vlerësimin e cilësisë së shërbimit arsimor në DRAP Durrës janë orientuar nga plani vjetor dhe ai mujor, por dhe nga problematikat e diktuar nga portali i “ Bashkëqeverisjes me Qytarët”

Për këtë periudhë SIVC ka kryer inspektime dhe monitorime në IAP dhe në ZVAP-e .

Theksojmë se inspektimet me natyrë vlerësimi janë mbështetur në Manualin e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të IA. Janë monitoruar me tematikë për cilësinë e realizimit të veprimtarisë mësimore-edukative, për përmirësimin e shërbimit arsimor parauniversitar, janë monitoruar me qëllim vlerësimin emasave të marra nga shkolla për përzgjedhjen dhe porositjen e teksteve shkollore për vitin shkollor 2021-2022 në 21 IPAP.

Është synuar të vlerësohen treguesit që kanë të bëjnë me hartimin e dokumentave kryesor për funksionimin e IA; plani afatmesëm, plani vjetor i shkollës, rregullorja e brendshme, mënyra e monitorimit dhe dokumentimit të vlerësimit të brendshëm të shkollës, bashkëpunimi i shkollës me aktorët dhe faktorët që janë përfitues të shërbimit arsimor, ose të interesuar për cilësinë e shërbimit të ofruar, si dhe shërbimi psiko-social.

Vlerësohet fakti se Sektori i Inspektimit ka dalë me përfundime, ka dhënë rekomandime dhe ka verifikuar zbatueshmërinë e tyre për IA, me synim përmirësimin e menaxhimit të brendshëm të shkollës.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.